

UDHËZIM
Nr.7714/1, datë 21.12.2001

**PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7564, DATË 19.5.1992 "PËR TË DREJTËN E AUTORIT",
NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.7923, DATË 19.4.1995, LIGJIN NR.8594, DATË 6.4.2000,
LIGJIN NR. 8630, DATË 3.7.2000, LIGJIN NR.8826, DATË 5.11.2001 TË VENDIMIT TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.309, DATË 13.6.2000 "PËR TARIFAT E PËRDORUESVE
TË PRONËSISË ARTISTIKE"**

Në mbështetje të nenit 102 dhe në zbatim të nenit 122 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga Konventat Ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe të pronësisë intelektuale të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr.7564, datë 19.5.1992 "Për të drejtën e autorit", ndryshuar me ligjet nr.7923, datë 19.4.1995, nr.8594, datë 6.4.2000, nr.8630, datë 3.7.2000 dhe 8826, datë 5.11.2001 dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.309, datë 13.6.2000 "Për tarifën e përdoruesve të pronësisë artistike", Ministri i Financave,

UDHËZON:

1. Organet tatimore në qendër dhe në rrethe të marrin masa për zbatimin korrekt të legjislacionit në fushën e së drejtës së autorit, nëpërmjet ushtrimit të kompetencave nga strukturat e Policisë Tatimore.

Në Drejtorinë e Policisë Tatimore në qendër, caktohet një inspektor për ndjekjen dhe koordinimin e detyrave për zbatimin e ligjit "Për të drejtën e autorit", ndërsa në degët rajonale të Policisë Tatimore të caktohen dhe të specializohen grupe të veçanta të kontrollit për zbatimin e këtij ligji. Me qëllim sigurimin e zbatimit të ligjit, Policia Tatimore bashkëpunon me shoqatat përkatëse të mbrojtjes të së drejtës së autorit.

2. Degët e tatimeve në rrethe të evidentojnë tatimpaguesit, të cilët ushtrojnë aktivitet në fushat e pronësisë intelektuale të artit, sipas përcaktimit në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.309, datë 13.6.2000.

3. Policia Tatimore dhe organet doganore, në zbatim të legjislacionit në fuqi, nuk lejon zhvillimin e veprimtarisë nga subjektet të cilat përdorin pronësinë intelektuale në fushën e artit, si subjekte prodhuese, importuese, përdorues, shitës apo qiradhënës dhe të cilët nuk kanë nënshkruar kontrata me shoqëritë e mbrojtjes të së drejtave të autorit, si dhe të ndalojnë prodhimin, importimin, tregtimin e kasetave, videokasetave, kompakdisqeve etj., që janë të pajisura me pullën përkatëse të shoqërive të mbrojtjes së të drejtave të autorit.

4. Me qëllim zbatimin korrekt të legjislacionit në fushën e së drejtës së autorit, për subjektet e përmendura në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.309, datë 13.6.2000, degët e tatimeve dhe taksave në rrethe kërkojnë:

- nga tatimpaguesit e biznesit të vogël, në momentin e regjistrimit dhe reregjistrimit në organin tatimor, kontratën e lidhur me shoqërinë e mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe pagesën për këto kontrata, si dhe pagesën për blerjen e pullave për pajisjen e kasetave, videokasetave dhe kompakdisqeve, nëse prodhojnë, importojnë këto mallra.

- nga tatimpaguesit e biznesit të madh, në momentin e dorëzimit të bilancit në organin tatimor, kontratën e lidhur me shoqërinë e mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe pagesën për këto kontrata, si dhe pagesën për blerjen e pullave për pajisjen e kasetave, videokasetave dhe kompakdisqeve, nëse prodhojnë, importojnë apo tregtojnë këto mallra.

5. Policia Tatimore ushtron kontrolle të përdoruesit e pronësisë intelektuale prodhuese, importuese, shitës apo dhënës me qira të kasetave, videokasetave, kompakdisqeve etj., për pajisjen e tyre me pullën e shoqërisë së mbrojtjes së të drejtave të autorit, si dhe nëse këto subjekte kanë nënshkruar kontrata me këto shoqëri.

6. Të kontrollohet dhe në zbatim të pikës 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.309, datë 13.6.2000, të ndalohet zhvillimi i spektakleve, shfaqjeve kinematografike etj., pa

lejen e autorëve të shoqërisë që autoritetet i kanë kaluar mbrojtjen e të drejtave të tyre.

7. Në zbatim të ligjit nr.8826, datë 5.11.2001 "Për disa shtesa në ligjin nr.7564, datë 19.5.1992 "Për të drejtën e autorit"", përbëjnë kundërvajtje administrative:

a) përdorimi i pronësisë artistike nga subjektet juridike dhe fizike, pa lejen e autorit apo pa kontratë me shoqëritë e mbrojtjes së të drejtave të autorit, shqiptar apo i huaj, në respektim të marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara nga Republika e Shqipërisë;

b) mospagimi në afat i detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i kontratave apo i autorizimeve midis autorëve shqiptarë apo të huaj, ose shoqërisë që mbron të drejtat e tyre, me përdoruesit e pronësisë artistike.

8. Shkeljet e parashikuara në ligjin nr.8826, datë 5.11.2001, kur nuk përbëjnë vepër penale, janë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë nga punonjësit e Policisë Tatimore, duke kërkuar përveç pagimit të gjobës, edhe arkëtimin e të drejtës së autorit sipas këtij ligji. Nga gjobat e vjela, 60 për qind kalojnë në Buxhetin e Shtetit dhe 40 për qind në llogari të shoqërisë për mbrojtjen e të drejtës së autorëve.

Procedurat e ekzekutimit të masës administrative bëhen në përputhje me ligjin "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë."

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Anastas Angjeli